



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2021:003647

Datë: 23.02.2021

Numri i dokumentit: 01530635

**P.nr. 61/21**

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË- Departamenti i Përgjithshëm,** Gjyqtarja Ilirjana Hoti, me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të akuzuarit A. V. nga Gjakova, për shkak të veprës penale dhuna në familje nga neni 248 par.1 të KPRK-së, veprës penale kanosje nga neni 181 par.4 lidhur me par. 2 të KPRK-së dhe veprës penale asgjësim apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë-Departamenti Përgjithshëm me numër PP/II.nr.32/21 të datës 03.02.2021 pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar **me datë 18.02.2021**, në prezencën e prokurorit të shtetit Mone Syla, të dëmtuarve S. V. dhe A. V. mbrojtësit të akuzuarit av. Xhevdet Këndusi sipas detyrës zyrtare si dhe të akuzuarit A. V., me datë **22.02.2021** mori dhe shpalli, këtë :

**A K T G J Y K I M**

I akuzuari **A. V.** nga Gjakovë, Rr". . . " nr. . . . data e lindjes . . . në Gjakovë, i biri i S. dhe i nënës A. e gjinisë A., analfabet, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, i martuar atë i dy fëmijëve, ashkali, shtetar i Republikës së Kosovës, ID . . . .

**Ë s h t ë f a j t o r**

**I.**

**Sepse:**

- **me datë 10.01.2021, rreth orës 17:00, në Gjakovë, Rr." . . . "**, saktësisht në shtëpinë e tyre të përbashkët, i pandehuri A. V., me qëllim të cenimit të dinjitetit të personit brena një marrëdhënie familje shkakton dhunë në familje, gjegjësisht keqtrajtim fizik të prindërve të tij, këtu të dëmtuarve A. dhe S. V., në atë mënyrë që paraprakisht i pandehuri i kishte kërkuar të dëmtuarës shumën e të hollave prej 30 Euro, për të blerë narkotik, dhe pasi që e dëmtuara refuzon që ti ia jap të hollat, i pandehuri i sulmon fizikisht të dëmtuarit duke i shtyrë, me ç rast të njëjtit rrëzohen për divan të ditës, me qka tek të dëmtuarit ka shkaktuar dhembje dhe shqetësim emocional.

- **me çka ka kryer veprën penale Dhuna në familje nga neni 248 par 1 të KPRK-së.**

**II.**

- **me datë 10.01.2021, rreth orës 17.00 min. në Gjakovë Rr. " . . . "**, saktësisht në shtëpinë e tyre të përbashkët, i pandehuri A. V., seriozisht i kanos prindërit e tij, këtu të dëmtuarit A. dhe S. V. se do i privojë nga jeta, në atë mënyrë që ditën kritike, pas një mosmarrëveshje të atëçastshme, ku paraprakisht i pandehuri i kishte kërkuar të dëmtuarve shumën e të hollave prej 30 euro për të blerë narkotik dhe pasi që e dëmtuara refuzon që të ia jap të hollat, i pandehuri i revoltuar fillon i drejtohet të dëmtuarve me fjalët se do të blejë armë dhe do ti vrasë ata e më pas edhe veten, me ç rast tek të dëmtuarit ka shkaktuar frike dhe ankth për jetën dhe sigurinë e tyre

- me çka ka kryer veprën penale **Kanosje nga neni 181 par. 4 lidhur me par. 2 të KPRK-së.**

### III.

- **me datë kohë dhe vend të njëjtë** si në pikën I të diapozitivit , dëmton apo bën të pa përdorshme pasurinë e personit tjetër , këtu të dëmtuarve –prindërve të tij A. dhe S. V. , në atë mënyrë që ditën kritike i pandehuri në shenjë revolte pasi prindërit nuk ua japin shumën e të hollave prej 30 euro për të blerë narkotikë, thyen derën e shtëpisë në dhomën e ndenjësisë dhe të njëjtën e bën të pa përdorshme , ku me këto veprime ka shkaktuar dëm material në vlerë të pa përcaktuar.

- **me çka ka kryer veprën penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par. 1 të KPRK-së.**

**Gjykata duke u bazuar në nenin 2, 4, 7, 17, 38, 39, 43,46, 47, 48, 49,69 ,70,72, nenit 248 par.1 , nenit 181 par.4-2 të KPRK-së si dhe nenit 321 par.1 të KPRK-së dhe nenit 365 të KPPK, të akuzuarin e gjykon :**

- **për veprën penale Dhuna në familje nga neni 248 par 1 të KPRK-së** të përshkruar si ne dispozitivin e I-të aktakuzës , dënimin me burgim në kohëzgjatje prej **7(shtatë ) muaj ,i cili dënim** nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda së verifikimit në afatin prej **2 (dy) vite**, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale **si dhe dënim me gjobë në shumë prej 500,00(pesëqind ) euro .**

- **për veprën penale Kanosja nga neni 181 par. 4 lidhur me par. 2 të KPRK-së** të përshkruar si ne dispozitivin e II-të të aktakuzës , dënimin me burgim në kohëzgjatje prej **8 (tetë) muaj** ,cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej **2 (dy) vite**, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

- **për veprën penale asgjësim apo dëmtim i pasurisë nga neni 321 par.1 të KPRK-së** , të përshkruar në pikën e III të aktakuzës, **Dënim me gjobë në shumën prej 380 (treqind e tetëdhjetë) euro.**

**Gjykata bazuar ne nenin 76 të KPRK-ës ,i shqipton :**

### DËNIMIN UNIK

Dënim burgu në kohëzgjatje prej **13 (trembëdhjetë ) muaj** , cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej **2 (dy) vite**, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale si dhe **me DËNIM ME GJOBË në shumën prej 880 (tetëqind e tetëdhjet ) Euro**, në të cilën dënim do të llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej datës 10.01.2021 e deri me datë 22.02.2021, në kohëzgjatje prej 44 ditëve, ashtu që për çdo ditë të kaluar në paraburgim do ti llogaritet nga 20 (njëzet) Euro, që i bie 880 (tetëqind e tetëdhjetë) uro.

**DETYROHET** i akuzuari që të bëjë vizita të rregullta te psikiatri në Qendrën e Shëndetit Mendor në Gjakovë,

**OBLIGOHET** Qendrën e Shëndetit Mendor në Gjakovë, që ta pranoj të akuzuarin A. V. ,për trajtimin e detyrueshëm rehabilitues për personat e varur nga droga dhe kohë pas kohe ta njoftoj gjykatën mbi gjendjen dhe suksesin e trajtimit të tij dhe atë së paku një herë në tre muaj, si dhe ta njoftoj gjykatën për çdo vështirësi në trajtim.

Detyrohet i akuzuari që në emër të kompensimit të viktimave të krimit ti paguaj shpenzimet në shumë prej **30,00€** si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej **20,00 €**, në afat prej **15 ditëve**, pasi Aktgjykimi të merr formë të prerë, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë .

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Gjakovë, Departamenti i Përgjithshëm, kësaj gjykate i ka parashtruar aktakuzën PP/II.nr.32/21 të datës 03.02.2021 kundër të akzuarit A. V. nga Gjakova , , për shkak të veprës penale dhuna në familje nga neni 248 par.1 të KPRK-së, veprës penale kanosje nga neni 181 par.4 lidhur me par. 2 të KPRK-së dhe veprës penale asgjësim apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par.1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar shqyrtimin fillestar me datën 18.02.2021 , në të cilin i ka ftuar të gjitha palët .

Prokurorja e shtetit Mone Syla , gjatë shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 18.02.2021 , lexoi aktakuzën dhe deklaroi se mbetet në tërësi pranë aktakuzës.

I akuzuari A. V. , gjatë shqyrtimit fillestar duke u deklaruar lidhur me fajësinë dhe pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij av. Xhevdet Këndusi , thekson se e pranon në tërësi fajësinë sipas aktakuzës me të cilën akuzohem duke i ditur edhe me parë pasojat dhe favorët e pranimit të fajësisë dhe atë në mënyrë vullnetare dhe pa presion , shtojë se me pranimin e fajësisë në çdo fazë të procedurës jam penduar për veprat e kryera ndaj prindërve të mi por e tera kjo ka ndodhur për shkak se jam i varur nga substancat narkotike dhe nuk kam pasur të holla që të sigurojë narkotikun edhe pse jam pacient i rregullt i Dr. I. G. psikiatër në Qendrën e Shëndetit Mental ku jam duke u trajtuar me qëllim që të kalojë këtë gjendje, kërkojë falje nga të dëmtuarit për veprimet e mija , premtimi se në të ardhmën nuk do të përsërisë vepra të natyrës së njëjtë dhe do të jem më i kujdesshëm me qene se jam i pa punë ,andaj i propozoi gjykatës që të merr parasysh të gjitha këto rrethanat lehtësues dhe të me shqiptojë një dënim me të butë .

Mbrojtësi av. Xhevdet Këndusi, deklaroi se i mbrojturi im me pranimin e fajësisë për veprat penale për të cilat akuzohet sipas aktakuzës , të cilën pranim e ka bërë pas konsultimit të mjaftueshëm me mua, ky pranim i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa presion ,andaj i propozoi gjykatës që me rastin e marrjes së vendimit të merr parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese të parapara me dispozitat ligjore të caktosh një dënim me të butë mundësisht një dënim të kushtëzuar e po ashtu i propozoi gjykatës që ndaj të njëjtit të ndërpritet edhe masa e paraburgimit i caktuar sipas vendimit të kësaj gjykate.

I dëmtuari S. V., gjatë shqyrtimit fillestar deklaroi se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga këtu i akuzuari , nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe nuk kërkojë kompensim dëmi me qene se të njëjtin nuk kemi pasur me parë probleme , i njëjti na ka mbajtur dhe të gjitha ato veprime ne ja falim .

E dëmtuara A. V. , gjatë shqyrtimit fillestar deklaroi se se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga këtu i akuzuari , nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe nuk kërkojë kompensim dëmi me qene se të njëjtin nuk kemi pasur me parë probleme , i njëjti na ka mbajtur dhe të gjitha ato veprime ne ja falim .

Duke u deklaruar lidhur me pranimin e fajësisë Prokurori i shtetit Mone Syla ,deklaroi se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga i akuzuari, pasi që i njëjti pranimin e fajësisë e ka bërë në mënyrë vullnetare pasi që i ka kuptuar pasojat dhe favorët e sqaruar nga ana e mbrojtësi të tij

e po ashtu të sqaruara edhe nga gjykata , aktakuza mbështet në provat në bazë të citave është paraqitur gjendja faktike në dispozitivat e saj ,ku edhe formohen elementet e veprave penale me të cilat ngarkohet i akuzuari ,mirëpo në rastin konkret potencoi faktin se përkundër të gjitha të lartcekurave i propozoi gjykate të këtë parasysh rrethanat renduese pasi që i njëjti është përsëritës i veprave penale të natyrës së njëjtë ,andaj me rastin e shqiptimit të dënimit të këtë parasysh të gjitha këto dhe të vetdisohet duke marr për bazë she shqiptimi i dënimit me të ashpër do të këtë pasoja efektive dhe në të ardhme do ta bëjë që të kuptoj për të mos kryer vepra të tilla penale pasi që i njëjti duke marr për bazë se është recidivist mund të kryej edhe në të ardhme edhe ndonjë vepër penale ,për faktin se kemi të bëjmë me dhunën në familje konkretisht në shtëpinë e vet.

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Në tërësi u vërtetua se i akuzuari A. V. : I. - **me datë 10.01.2021, rreth orës 17:00, në Gjakovë, Rr. . . .** , saktësisht në shtëpinë e tyre të përbashkët , i pandehuri A. V. , me qëllim të cenimit të dinjitetit të personit brena një marrëdhënie familje shkakton dhunë në familje, gjegjësisht keqtrajtim fizik të prindërve të tij, këtu të dëmtuarve A. dhe S. V. , në atë mënyrë që paraprakisht i pandehuri i kishte kërkuar të dëmtuarës shumë e të hollave prej 30 Euro, për të blerë narkotik, dhe pasi që e dëmtuara refuzon që ti ia jap të hollat , i pandehuri i sulmon fizikisht të dëmtuarit duke i shtyrë , me ç rast të njëjtit rrëzohen për divan të ditës, me çka tek të dëmtuarit ka shkaktuar dhembje dhe shqetësim emocional. **II. - me datë 10.01.2021 , rreth orës 17.00 min . në Gjakovë Rr. “. . . ”**, saktësisht në shtëpinë e tyre të përbashkët , i pandehuri A. V. , seriozisht i kanos prindërit e tij , këtu të dëmtuarit A. dhe S. V. se do i privojë nga jeta , në atë mënyrë që ditën kritike, pas një mosmarrëveshje të atëçastshme,ku paraprakisht i pandehuri i kishte kërkuar të dëmtuarve shumë e të hollave prej 30 euro për të blerë narkotik dhe pasi që e dëmtuara refuzon që të ia jap të hollat , i pandehuri i revoltuar fillon i drejtohet të dëmtuarve me fjalët se do të blejë armë dhe do ti vrasë ata e më pas edhe veten , me ç rast tek të dëmtuarit ka shkaktuar frike dhe ankth për jetën dhe sigurinë e tyre. dhe **III. - me datë kohë dhe vend të njëjtë** si në pikën I të diapozitivit , dëmton apo bën të pa përdorshme pasurinë e personit tjetër , këtu të dëmtuarve –prindërve të tij A. dhe S. V. , në atë mënyrë që ditën kritike i pandehuri në shenjë revolte pasi prindërit nuk ua japin shumë e të hollave prej 30 euro për të blerë narkotikë, thyen derën e shtëpisë në dhomën e ndenjës dhe të njëjtën e bën të pa përdorshme , ku me këto veprime ka shkaktuar dëm material në vlerë të pa përcaktuar.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprave penale të përshkruara si në dispozitivat e këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta shpallë fajtor dhe ta gjykojë në bazë të ligjit, më parë duke vërtetuar përgjegjësisë penale juridike të tij.

Nga raporti mbi gjendjen e shëndetit mendor të Instituti i Psikiatrisë Forenzike pranë SHSKUK në Prishtinë, për të akuzuarin me numër të protokollit nr. 39/2/2 të datës 27.01.202, është konstatuar se i akuzuari A. V. , evidentohet me çrregullim mendor dhe çrregullim i sjelljes si pasojë e përdorimit të opiateve –sindroma e varshmërisë ( F11.3 sipas ICD10) , ku një gjendje e tillë karakterizohet me çrregullime të sjelljes me qëllim të sigurimit të sasive të opioideve pasojë e varshmërisë fiziologjike dhe psikikë por bazuar në të dhënat e siguruar në shkresat e lëndës , konstatohet se llogaritshmëria për veprën penale ka qenë e ruajtur.

Gjykata duke u bazuar në këtë raport të akuzuarin e ka detyruar që të bëjë vizita të rregullta të psikiatri në Qendrën e Shëndetit Mendor në Gjakovë. Po ashtu gjykata e ka obliguar Qendrën e Shëndetit Mendor në Gjakovë, që ta pranojë të akuzuarin A. V. ,për trajtimin dhe rehabilitim për personat e varur nga droga dhe kohë pas kohe ta njoftoj gjykatën mbi gjendjen dhe suksesin e trajtimit të tij dhe atë së paku një herë në tre muaj, si dhe ta njoftoj gjykatën për çdo vështirësi

në trajtim, e këtë në mungesë të ndonjë Institucioni përkatës për trajtim të personave e varur nga droga .

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj te akuzuarës, gjykata ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 69 dhe 70 të KPRK-së ,të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit. të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit. Rrethanë rënduese gjykata konsideron faktin se i akuzuari ka kryer veprat penale të përshkruara në dispozitiv të këtij aktgjykimi ndaj familjarëve të tij gjegjësisht prindërve të tij të cilët janë edhe në moshë të shtyrë ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit se i njëjti është baba i 2 fëmijëve, pranimin e fajësisë çdo fazë të procedurës , sjelljen korrekte në gjykim, kërkim falja nga të dëmtuarit për veprimet e tij, premtimi se një veprim i tillë nuk do te përsëritet, deklarimi i të dëmtuarve se nuk i bashkëngjiten ndjekjes penale dhe nuk kërkojnë kompensim dëmi si dhe gjendjen e dobët ekonomike. Kështu që gjykata të akuzuarit i shqiptoj dënimin unik Dënim burgu në kohëzgjatje prej 13 (trembëdhjetë ) muaj , cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej 2 (dy) vite, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale si dhe me DËNIM ME GJOBË në shumën prej 880 (tetëqind e tetëdhjet ) Euro, në të cilën dënim do të llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej datës 10.01.2021e deri me datë 22.02.2021, në kohëzgjatje prej 44 ditëve, ashtu që për çdo ditë të kaluar në paraburgim do të llogaritet nga 20 (njëzet) Euro, që i bie 880 (tetëqind e tetëdhjetë) Euro, me bindje se do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 38 dhe 47 i KPRK-së .Gjykata beson se me shqiptimin e sanksionit të tillë do të ndikojë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Gjykata nuk i ka udhëzuar të dëmtuarit në kontest civil për realizimin e kërkesës së tyre pasurore - juridike, pasi që e njëjtit nuk kanë parashtruar kërkesë të tillë .

Vendimi mbi shpenzimet në emër të paushallit gjyqësor në shumë prej 20,00 €, është bazuar në dispozitat e nenit 450 par.1dhe 2 nën paragrafi 2.6 te KPPK-së, ndërsa për programin për kompensimin e viktimave të krimit në shumë prej nga 30.00 € është marr konform nenit 39 par.3 nën.par.3.1 të Ligjit Nr. 05/L-036. për kompensimin e Viktimave të Krimit .

Nga sa u tha me lart, u vendos si ne dispozitiv te këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË**  
**Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Penal**  
**P.nr.61/21 datë 22.02.2021**

**Sekretarja juridike**  
**Flutur Nagavci**

**Gjyqtarja**  
**Ilirjana Hoti**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi, palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afat prej 15 ditëve, duke llogaritur nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.

Numri i lëndës: 2021:003647  
Datë: 23.02.2021  
Numri i dokumentit: 01530635